



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019), neni 40 dhe Neni 41 i Rregullores së Punës të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe udhëzimet për rangim të lëndëve për veprim të Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në bazë të denoncimeve të dorëzuara nr.03-2233 / 1 të datës 12.02.2021 KSHPK (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) në seancën e 50 -të të mbajtur më 21.07.2021 mori

Vendim

Procedura për kontrollimin e të dhënave mbi gjendjen e pronës nga lista anketuese të -----, Ministër - - - - - i ngarkuar me tërheqjen e investimeve të huaja, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm nga KSHPK- ja sipas lëndës me numër 08-4172/1 të datës 04.09.2019.

Lënda me numër 08-4172/1 datës 04.09.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4172 / 1 të datës 04.09.2019 është formuar në bazë të Planit Vjetor për monitorimin e situatës së pronës dhe interesave për vitin 2019.

KSHPK, për personin e emëruar nga MPB kërkoi të dhëna për anëtarët e familjes së tij me të cilët ai jeton në një shtëpi të përbashkët.

Të dhënat e kërkuara për të emëruarin u dorëzuan nga MPB.

KSHPK, me qëllim përcaktimin e gjendjes faktike në rastin konkret, mori të dhëna për pasurinë e ----- dhe anëtarëve të familjes së tij nga Agjencia për Kadastër të patundshmërisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e të Hyrave Publike, Depozituesi Qendror i Letrave me Vlerë dhe Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KSHPK, pas shqyrtimit të të dhënave të marra nga institucionet e përmendura, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Nikolina Tarçullovskaja-Miloshevska, këshilltare
Miratoi: Sofka Pejovska Dojcinovska, anëtare

KOMISIONI SHETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

